



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 739/6 Prot.

Tiranë, më 22.12. 2015

V E N D I M
Nr. 131, datë 22.12.2015

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
filluar me Urdhrin e verifikimit Nr.739/1 prot, datë 05.11.2015**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Institucionin e Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve për rastin e nëpunësit ***** ,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit të verifikimit Nr.739/1 prot, të datës 05.11.2015, pasi shqyrtova informacionin e përcjellë nëpërmjet kërkesës Nr. 739 prot, datë 03.11.2015 paraqitur nga kërkuesi ***** , vendosa nisjen e verifikimit në lidhje me ligjshmërinë e Vendimit Nr.841, datë 30.10.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, "Për delegimin e kompetencave për një afat të pacaktuar, të Inspektorit të Parë në Sektorin e Verifikimit në Terren, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, ***** , aktualisht me detyrë, Përgjegjës në Sektorin e Menaxhimit të Riskut, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve".

Nga aktet e administruara rezulton se, punonjësi ***** me Vendimin Nr.586 datë 25.02.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, në zbatim të një vendimi gjyqësor, është emëruar në pozicionin e "Përgjegjësit në Sektorin Menaxhimit të Riskut", pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Ky punonjës ka qënë pjesë e administratës tatimore prej më shumë se 20 vjetësh, për këtë arsye ai ka përfutur statusin e nëpunësit civil në bazë të ligjit Nr. 8549, dt. 11.11.1999, "*Statusi i nëpunësit civil*", status i cili është rikonfirmuar edhe në zbatim të nenit 67 të ligjit Nr.152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.

Në datë 30.10.2015, me aktin Nr.841, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka urdhëruar delegimin e kompetencave, tek nëpunësi ***** , me detyrë "*Përgjegjës në Sektorin e Manaxhimit të Riskut, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve*", për të kryer për një afat të pacaktuar, detyrën e "*Inspektorit të Parë në Sektorin e Verifikimit në Terren*", në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë.

Akti i Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, është bazuar në nenin 27, të ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative në R.SH*", i ndryshuar; në ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në R.SH*", i ndryshuar; si edhe në ligjin Nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar.

Po ti referohemi neneve 27 deri 32, të ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative në R.SH*" që rregullojnë institutin e delegimit të kompetencave konstatohet se në to, parashikohen rastet kur organet administrative kompetente mund të delegojnë kompetencat e tyre te një organ tjetër i administratës, apo ti delegojnë këto kompetenca tek organet e tyre vartëse, duke vendosur kritere të veçanta të cilat duhet të respektohen në këto raste.

Nga kjo analizë e këtyre dispozitave, duke mbajtur në vëmendje edhe doktrinën e të drejtës administrative për këtë rast, rezulton se, delegimi i kompetencave, parashikohet si e drejta që kanë organet administrative më të larta, për të kaluar atributet e ushtrimit të pushtetit të tyre ekzekutiv, ose urdhërdhënës, tek organet më të ulëta hierarkike, brenda këtij sistemi, duke rregulluar njëkohësisht edhe procedurën se si realizohet ky proces.

Kështu, në nenin 29, të ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative në R.SH*", në pikën 1 të tij, përcaktohen shprehimisht kriteret për delegim, të cilat janë kusht pa të cilin delegimi i kompetencave nuk mund të konsiderohet si i kryer në përputhje me ligjin. Konkretisht, në një rast delegimi, organi përcakton qartë kompetencat të cilat janë deleguar, ose tregon se çfarë aktesh mund të nxjerrin, apo të zbatojnë organet e deleguara. Po kështu, në pikën 2 të këtij neni, është përcaktuar detyrimi ligjor që ka organi delegues që të botojë në Fletoren Zyrtare delegimin e kompetencave.

Gjithashtu, në nenin 31 të ligjit në fjalë, në pikën 1 të tij, është i shprehur qartë detyrimi ligjor, që organi delegues ka për të nxjerrë udhëzime, të cilat kanë lidhje me mënyrën e ekzekutimit të kompetencave të deleguara, ç'ka në rastin konkret, nuk janë vënë në dispozicion nga palët në këtë hetim administrativ.

Pra, sa më sipër rezulton se, procesi i delegimit të kompetencave, është një proces i gjerë dhe kompleks, i përbërë nga një sërë elementësh, si në përmbajtje ashtu edhe në procedurë, të cilët në rastin konkret, nuk janë prezent. Për këtë arsye, si dhe duke pasur parasysh përmbajtjen e aktit administrativ objekt i këtij hetimi administrativ, arrihet në përfundimin se gabimisht nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme, është trajtuar rasti si një delegim kompetencash, duke iu referuar

Kodit të Procedurave Administrative, kur nuk ka asnjë nga elementët e kërkuar nga ligji, pasi ky i fundit parashikon delegimin e kompetencave midis organeve administrative, dhe jo midis këtyre dhe nëpunësve civil, brënda të njëjtës strukturë.

Në rastin konkret kemi të bëjmë me një punonjës të administratës tatimore, i cili është në varësi direkte të Drejtorit të Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, e cila është një njësi, në përbërje të strukturës së Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve.

Detyrat funksionale dhe kompetencat ligjore të këtyre njësive organizative, janë të përcaktuara qartë në dispozitat e ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 *“Për Procedurat Tatimore në R.SH”* (i ndryshuar) dhe të Rregullores së miratuar nga Ministri i Financave, me aktin administrativ Nr. 13018/1, datë 04.10.2010, *“Rregullore e Brëndshme e Administratës Tatimore Qëndrore”*.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, është një institucion qëndror në varësi të Ministrisë së Financave, sipas përcaktimeve të nenit 13 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 *“Për Procedurat Tatimore në R.SH”*, i ndryshuar, dhe si i tillë, përfshihet në fushën e veprimit të ligjit Nr. 152/2015 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Për këtë arsye, transferimi i një nëpunësi civil, rregullohet në mënyrë të posaçme nga dispozitat e nenit 48, 49 e 50 të ligjit Nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar. Konkretisht, në bazë të këtyre dispozitave, një nëpunës civil, për interes të institucionit, (siç pretendohet në rastin konkret), apo për arsye të tjera ligjore që parashikohen në to, mund të transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil, me një kohëzgjatje jo më shumë se 6 muaj gjatë dy viteve, duke ruajtur kategorinë, ose në mënyrë të përhershme, në rastet e ristrukturimit apo mbylljes së institucionit.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se, në rastin konkret, kemi të bëjmë me zbatim të gabuar të dispozitave ligjore, e konkretisht;

Së pari, rezulton se janë zbatuar dispozitat e ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999 *“Kodi i Procedurave Administrative në RSH”*, i cili është një ligj me karakter procedural, dhe jo ligji Nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, i cili është një ligj i posaçëm, që rregullon marrdhënien e punës në shërbimin civil.

Pavarësisht faktit se në aktin administrativ objekt shqyrtimi, nga ana e drejtuesit të Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve është përdorur termi *“delegim i kompetencave”*, në fakt kemi të bëjmë me një lëvizje në detyrë (*transferim*), të një nëpunësi civil, e cila duhet të bëhet në përputhje me ligjin, në të njëjtën kategori dhe vetëm brenda kufijve kohorë të vendosur nga neni 48, i ligjit Nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, (6 muaj brenda dy vjetëve).

Së dyti, në aktin Nr.841 datë 30.10.2015, *“Për delegimin e kompetencave për një afat të pacaktuar, të Inspektorit të Parë në Sektorin e Verifikimit në Terren, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë”*, konstatohet se nuk është ruajtur e njëjta kategori, ashtu si e kërkojnë kushtet e nenit 48 pika 1/a të ligjit organik, që rregullon aktualisht shërbimin civil.

Në bazë të nenit 19, të ligjit Nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, pozicionet e punës në shërbimin civil ndahen në kategoritë, a) të lartë drejtues; b) të mesëm drejtues; c) të ulët drejtues dhe ç) ekzekutiv.

Pika 6 e kësaj dispozite, përcakton se, pozicioni “Përgjegjës sektori” (ashtu si e gëzon statusin e nëpunësit civil, punonjësi *****), është pozicion i kategorisë së ulët drejtuese, ndërkohë që pozicioni i punës, “Inspektor”, ku ky nëpunës është transferuar aktualisht, në bazë të pikës 7 të nenit në fjalë, është pozicion i kategorisë ekzekutive.

Si përfundim, mosrespektimi i kriterëve në një rast transferimi të përkohshëm, si ai i ruajtjes së kategorisë në shërbimin civil, ashtu dhe mos përcaktimi i kohëzgjatjes së këtij transferimi, në përputhje me kushtet e kërkuara nga dispozitat e ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e bën aktin të kundraligjshëm, gjë që në vështirësi të nenit 115, pika “a”, të ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”, passjell pavlefshmëri absolute të aktit objekt hetimi administrativ. Duke qenë i tillë në bazë të nenit 117, pika “1”, të Kodit të Procedurave Administrative, nuk mund të prodhojë pasoja ligjore, pavarësisht nga fakti se janë deklaruar ose jo si të tillë.

Në rastin konkret, konstatoj se jemi para një transferimi të përkohshëm, për nevoja të institucionit dhe veprimi administrativ duhet të klasifikohet si i kundraligjshëm, për shkak të mosrespektimit të kërkesave të nenit 48 të ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Nëse do të ndodheshim në kushtet e transferimit të përhershëm, duke u nisur nga përmbajtja e neneve 49 dhe 50 të ligjit organik për nëpunësin civil, duhet të ndodheshim përpara rasteve të parashikuara në ligj dhe konkretisht; a) të paaftësisë shëndetsore të nëpunësit për të kryer detyrën, b) shmangies së konfliktit vazhdueshëm të interesit, transferimit në rast mbyllje apo ristrukturim të institucionit, etj.

Në rastin konkret nuk jemi para asnjërit prej këtyre kushteve, prandaj duke përjashtuar ekzistencën e një transferimi të përhershëm, mbetet konkluzioni se jemi në kushtet e një transferimi të përkohshëm, të kryer në shkelje të përcaktimeve ligjore, për këtë arsye arsyetimi i bërë më sipër, për kundërligjshmërinë e tij, vlerësohet i drejtë dhe përfundimtar.

Së treti, duke iu referuar shkresës Nr. 34125, datë 30.10.2015 që shoqëron aktin e delegimit, për dijëni Departamentit të Administratës Publike, dhe shkresës Nr. 5459/1, datë 27.11.2015, të Departamentit të Administratës Publike, Drejtuar Komisionerit, në përgjigje të kërkesës për informacion me Nr. 739/3, datë 05.11.2015, në lidhje me rastin që po shqyrtohet, rezulton se D.A.P, nuk ka patur rol aktiv në këtë procedurë. Nga përmbajtja e kësaj shkrese, rezulton se Departamenti i Administratës Publike, ka kërkuar sqarim për rastin në fjalë pranë Drejtorisë së Përgjithëshme të Tatimeve, në lidhje me procedurën e ndjekur, ç’ka do të thotë se nuk ka qenë pjesë e saj.

Në kushtet kur Departamenti i Administratës Publike, i cili është institucioni në rolin e njësisë përgjegjëse në këtë rast, dhe në përputhje me rregullimet e Kreut I, “Transferimi i përkohshëm”, pika 10, e Vendimit Nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” ka detyrimin ligjor që të finalizojë transferimin e përkohshëm, kur nuk e ka kryer rolin e tij, kjo përbën shkelje flagrante të ligjit.

Ndodhur në kushtet e mësipërme, çmoj se në këtë rast, është e nevojshme ndërhyrja e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për të rregulluar ligjshmërinë e veprimit administrativ të kryer, duke kërkuar revokimin e aktit Nr. 841 datë 30.10.2015, të Drejtorisë së Përgjithëshme të Tatimeve, “Për delegimin e kompetencave për një afat të pacaktuar, të Inspektorit të Parë në Sektorin e Verifikimit në Terren, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, ***** , aktualisht me detyrë, Përgjegjës në Sektorin e Manaxhimit të Riskut, në

Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve", si një akt i dalë në kundërshtim me Ligjin Nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, dhe kthimin e nëpunësit ***** në pozicionin e mëparshëm të punës.

Po kështu, në këtë rast, duhet që njësia e burimeve njerëzore e institucionit, të na informojë nëse ka raste të tjera, të kësaj natyre, të trajtuara në të njëjtën mënyrë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14 dhe 15 të ligjit Nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*" i ndryshuar; nenet 115 pika "a" dhe 117 pika 1, të ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999, "*Kodi i Procedurave Administrative në R.SH*"; nenin 35 të Rregullores së K.M.SH.C-së, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil", "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*",

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, revokimin e aktit Nr. 841, datë 30.10.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, "*Për delegimin e kompetencave për një afat të pacaktuar, të Inspektorit të Parë në Sektorin e Verifikimit në Terren, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, ******", aktualisht me detyrë, Përgjegjës në Sektorin e Menaxhimit të Riskut, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve", si një akt i dalë në kundërshtim flagrant me Ligjin Nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe nëpunësi ***** , të kthehet në pozicionin e mëparshëm të punës, si "*Përgjegjës në Sektorin e Menaxhimit të Riskut*" në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve .
2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të zbatojë Vendimin brenda 15 ditëve nga data e marrjes dijeni.
3. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Departamenti i Administratës Publike si dhe kërkuesi, ***** .
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA